

MNN Qendrore

MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

24 Shtator 2025

Rajonet: Afrika, Azi-Paqësori, Euroazia, Mesoamerika, Amerika e Jugut, SHBA- Kanada



“Zonat Shtesë”

Puna në “Zonat Shtesë” filloi në vitin 1994 dhe vazhdon deri më sot. Këto “Zona Shtesë” ndodhen në disa nga rajonet ku Kisha e Nazaretasit ka shërbesë. Këto zona kanë tendencë të jenë rezistente ndaj ungjillit, që do të thotë se shpallja e hapur e ungjillit mund të jetë e kufizuar, duke kërkuar qasje krijuese për shërbesën dhe misionin. Ato gjithashtu mund të jenë zona ku Kisha e Nazaretasit është regjistruar zyrtarisht në qeveri, por mjedisi politik, shoqëror ose fetar nuk është gjithmonë i favorshëm për përhapjen e krishterimit dhe zhvillimin e kishës. Shpesh, ne lidhim gjuhë të caktuara me shtete të caktuara në të cilat jemi të përqendruar. Megjithatë, në këtë rast, gjuha që ka më shumë rëndësi është gjuha e hirit dhe dashurisë, duke ndarë shpresën në Krishtin. Ata që shërbejnë në këto zona duhet të dinë se janë të dashur dhe se lutemi për ta. Pavarësisht rrethanave politike, ekonomike, sociale ose fetare, Kisha e Nazaretasit është e pranishme për të dëshmuar dashurinë e pakushtëzuar të Perëndisë ndaj njerëzve të të gjitha moshave, që jetojnë në çdo lloj situatë njerëzore.



16,606 Anëtarë



134 Kisha të organizuara
plotësisht; 122 Kisha
ende të paorganizuara



26 Shërbëtorë të
liçensuar dhe 17
Shërbëtorë të shuguruar

LUTJE



- Lutuni që ata që shërbejnë në "Zona Shtesë" të mund të takojnë persona të kulturës vendase që mund të jenë 'persona të besueshëm të paqes' - ndërtues urash për t'u bërë partnerë në besim.
- Lutuni që Perëndia të sigurojë mundësi në 'të papriturën' për të ndarë shpresën e lirisë në Jezusin me të tjerët.
- Lutuni për heqjen e pengesave, si njerëzore ashtu edhe sistemike, për të marrë vizat e duhura, duke i dhënë legjitimitet në vend.

LAVDËRIM



- Lavdëroni Perëndinë për udhëheqësit që janë tashmë në vend, të cilët e njohin Atë dhe kanë gjetur mënyra kuptimplote për t'i shërbyer Atij, pavarësisht kufizimeve që u janë vendosur, madje edhe nga besimtarë të tjerë.
- Lavdëroni Perëndinë për ata që duan të bashkohen në këtë udhëtim dhe të përjetojnë mrekullinë e thirrjes dhe besnikërinë e Perëndisë në vende të vështira shërbimi.
- Lavdëroni Perëndinë për të rinjtë që ndoshta lihen pas dore si punëtorë në një mision të tillë, por që megjithatë po i thonë "Po" Perëndisë!



Sara* është punëtorja e parë ndërkulturore e Kishës Nazaretase nga një vend kryesisht Mysliman në Paqësorin Jugor. Vendi i saj i lindjes nuk di vërtet si ta mbështesë atë në misionin për të cilin Perëndia e ka thirrur. Të jesh e para do të thotë të krijosh lloje të reja marrëdhëniesh. Ajo takoi burrin e saj, i cili kishte qenë misionar për nëntë vjet, dhe që mbështetej nga distrikti i tij i lindjes gjysmë bote larg. Si çift, ata shpresonin që kisha e saj do të lutej për ta, por kisha e saj nuk dinte si ta bënte këtë. Ajo tha: "Disa nuk e shohin si mundësi një person që vjen nga një vend jo i Krishterë, femër dhe e re, si punëtorë ndërkulturore për Krishtin." Ajo vazhdoi, "Nuk e mbaj mend herën e fundit që kisha ose distrikti im dërgoi ndonjë mesazh se po luteshin për ne. Njerëzit thjesht nuk mendojnë të ta thonë atë. Por, në një vend të ri shërbese, ndihesh kaq shumë e vetmuar, pa e ditur nëse dikush po lutet për ty."

Disa muaj pasi u zhvendosën në shërbesën e tyre të re, ata morën një mesazh nga Distrikti i Lidhjeve në Shtetet e Bashkuara, i cili i kontaktoi ata. Më shumë se një person dhe më shumë se një kishë i shkruajtën atyre. Ishte hera e parë që ata ishin lidhur me një distrikt që filloi komunikimin me ta, duke i pyetur se si po shkonin dhe duke e siguruar këtë çift të ri se po luteshin për ta. Sara dhe burri i saj komunikojnë rregullisht për të ndarë çfarëdo përditësimesh që mund të kenë, por ata rrëfejnë se shumë gjëra që do të donin të ndanin thjesht nuk janë të këshillueshme, duke pasur parasysh kontekstin në të cilin shërbejnë. Disa kisha kanë mbledhur oferta për të dërguar për të mbështetur punën e tyre, të cilat kanë qenë një bekim, por dhurata më e rëndësishme është ajo e 'lidhjes dhe mbështetjes me lutje'. Kjo tregon më shumë se çdo gjë tjetër se ata janë të dashur dhe të kujdesur për ta.

Distrikti i tyre i Lidhjes i ftoi ata të vinin dhe të flisnin në Asamblenë e Distriktit të tyre, dhe ata patën mundësi të vizitonin më shumë se 10 kisha dhe të ndanin punën që po bëjnë në një kontekst sfidues.

"Ky ishte një bekim i madh," thanë ata. Gjatë turit të vizitave të kishave, ata patën mundësi të ftonin miq Nazaretas të vinin dhe të vizitonin vendin ku ata shërbenin, i cili është i hapur për vizitorët, por që heziton të pranojë punëtorë ndërkulturore. Shumë nga kishat në të cilat ata folën përbëheshin nga kultura minoritare. Në një kishë, një zonjë tregoi se kohët e fundit ajo ndjente në zemër për myslimanët, duke u lutur shpesh për ta, por nuk njihte askënd që punonte me ose midis tyre, derisa takoi këtë çift. Ajo u mbush me gëzim që Zoti kishte vënë dorën e Tij mbi një çift të ri, të cilin ajo e takoi ballë për ballë, për të bërë pikërisht këtë - për të punuar me myslimanët.

Një kishë tjetër tregoi se ata ishin lutur për ta edhe pse nuk i njihnin. Ata nuk i kishin parë kurrë fytyrat e tyre, por prapëseprapë, i donin! "Kjo ndryshon gjithçka," tha Sara. "Gëzimi i përkatësisë zëvendëson ndjenjën e izolimit dhe vetmisë në një vend të huaj."



Pyetje dhe Përgjigje nga Shërbesa në "Zona Shtesë"

- "Çfarë e konsideroni më sfiduese për ju në lidhje me të qenit 'në shërbim' në një 'Zonë Shtesë'?"

"Ne duhet të ruajmë gjithçka që bëjmë, dhe kufizimet nën të cilat kërkojmë të ndërtojmë marrëdhënie janë si mure. Rezultatet janë të ngadalta... mbështetja shpirtërore në një 'vend të errët' është pothuajse e pamundur, megjithatë ne ndiejmë mbështetjen e anëtarëve të largët të familjes brenda Kishës së Nazaretasit në anën tjetër të botës."

- "Cila ka qenë përvoja juaj më e madhe e kujdesit të Perëndisë gjatë kohës së shërbimit tuaj në një 'Zonë Shtesë'?"

"Pa u planifikuar nga ne, një grup studentësh të seminarit arritën të përjetonin jetën në një kontekst të panjohur... dhe ndërsa ata u trajtuan si 'të huaj', sepse kështu shihen të huajt: me dyshim, ky grup u bë një urë lidhëse shoqërie me Sarën dhe burrin e saj ndërsa ata ishin atje, gjë që ka siguruar marrëdhënie të vazhdueshme që japin mundësi për të ndarë nevojat e lutjes dhe për të festuar përgjigjet nga Zoti."

- "Çfarë do të dëshironit që kisha lutëse të dijë , se si është të shërbesh në një 'Zonë Shtesë'?"

"Çdo ditë, duhet të presim të papriturën. Nuk është një 'mjedis normal', ose një mjedis që kuptohet në mënyra të zakonshme nga shumica e njerëzve. Gjërat janë të pastrukturuara dhe për këtë arsye, shpesh të pakëndshme. Është e vështirë të përshkruhet me fjalë. Mund të gënjejë mendjen, duke menduar nëse ajo që sheh në jetën e një 'besimtari' është autentike apo jo. Por ne kemi mësuar t'i besojmë Perëndisë që po punon në çdo jetë me anë të hirit të Tij, dhe të mos gjujkojmë askënd, por ta lejojmë Perëndinë të zbulojë Vetveten në jetën e tyre siç zgjedh Ai, dhe të rrisë jetët tona në këtë vend, siç zgjedh Ai."

*Emri është ndryshuar për arsye sigurie.

.....

A mund të shërbeni?

A po ju thërret Perëndia që të jesh në dispozicion për t'u bashkuar Atij në misionin e Tij në "Zonat Shtesë"? Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

.....

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).

.....



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US



KISHA e
NAZARENIT